



01 Nr. 248/26 Dt. 10.06.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr-28/2008), e në mbështetje të nenit 44 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr-20/2016), si dhe nenin 50 dhe 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit 01/011-5643, datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim, Salla e Edukatës Fizike, e cila gjendet në Romajë dhe menaxhohet nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kalon në menaxhim të Shkollës Filllore të Mesme të Ultë “Bajram Curri” në Romajë.
2. Salla e Edukatës Fizike, e cekur si në pikën 1 të këtij vendimi, do të shfrytëzohet edhe nga paralelet e ndara fizike të shkollave të mesme deri në ndërtimin e një salle tre përkatëse.
3. Obligohet stafi menaxhues i Shkollës Filllore të Mesme të Ultë “Bajram Curri” në Romajë që të bëjë menaxhimin e Sallës së Edukatës Fizike në këtë shkollë, konform legjislacionit në fuqi.
4. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe menaxhmenti i ShFMU “Bajram Curri” në Romajë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës
 - Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - ShFMU “Bajram Curri” në Romajë”
 - Arkivës së Kryetarit.